



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3174 / Prot. 138

Patos, më 26 / 11 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 25 NËNTOR 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjuesë publike me temë: “Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj.

Në total: 56 pjesëmarrës

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit



Kryetari i Këshillit

z. Armand Ahmetaj

Dëgjese publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të prezantuar para jush dokumentin përfundimtar lidhur mbi buxhetin 2026 dhe PBA 2026-2028 dhe ky është një moment shumë i rëndësishëm për të gjithë. Ftoj ekzekutivin të prezantoj materialin dhe sipas rregullave mund të drejtoni pyetjet tuaja.

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– përshëndetje të gjithëve! Sot do prezantojmë materialin përfundimtar para jush. Pasi kemi kaluar një sërë dëgjesh dhe kemi



Drejtores

Znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjese publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

marrë gjithë kërkesat tuaja në shqyrtim kemi arritur në një draft përfundimtar. Buxheti i vitit 2026 zë vlerën 733 milion e 839 mijë lekë. Ky buxhet përbëhet nga tre burime kryesore. Përbëhet nga të ardhurat, transfertat e kushtëzuar dhe ajo e pakushtëzuar. Peshat specifike për çdo burim është, 45% mbulohen nga të ardhurat e buxhetit, 34% mbulohen nga transfertat e kushtëzuar dhe pjesa tjetër nga ajo sektoriale. Vlen për tu theksuar që jemi në rritje të të ardhurave nga buxheti total. Po ti referohemi peshës specifike që zen investimet me të

ardhurat kemi një raport 27% të të ardhurave që mbulojnë investimet me rritje nga 2025 kundrejt të ardhurave 45%. Një element i rëndësishëm është edhe shpërndarja e buxhetit sipas klasifikimit ekonomik ku 44.9% janë shpenzimet për pagat, 7.4 për sigurimet shoqërore etj. Duke bërë një krahasim të burimeve financiare për vitin 2026 me vitin 2025 kemi një rritje prej 8.5% të buxhetit. Buxheti i bashkisë është hartuar duke ndjekur strukturën organizative të hartuar nga Ministria e Financave që për herë të parë jemi nga 12 bashkitë e projektuara si bashki. E kemi ndarë buxhetin në 6 programe. Prioritetet e bashkisë vazhdojnë të jenë zhvillimi ekonomik urban, sporti dhe çështjet sociale dhe punët publike. Në vazhdim janë emërtimi i projekteve që do plotësojnë gjithë kërkesat e marra në dëgjuesat publike.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro prezanton materialin e buxhetit- Përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bashkuar sot me ne. Ky është një takim i rëndësishëm për ne pasi një pjesë e projekteve të 2026 janë edhe pjesë e PBA-së.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.
Nëntor 2025**

Një pjesë e investimeve të bashkisë do të jenë shumë të nevojshme dhe do mbulojnë tre njësitë e bashkisë. Një pjesë e projekteve do përfundojnë që këtë vit. Investimi të lagjja Naftëtari ka përfunduar dhe ishte pjesa më problematike. Gjithashtu ne kemi parashikuar te ajo lagje të përfundoj edhe pjesa tjetër e saj dhe në vitin 2026 të mbyllet e gjitha. Investim që fillon këtë vit është rikonstruksioni në lagjen 1 Maj, që do filloj në Dhjetor dhe përfshin rikonstruksionin e blloqeve pranë shkollës “Hekuran Maneku” dhe te rruga “Koli Marku”. Kjo është një ndërhyrje që do përfshij ndërtimin e rrjetit të ujërave të bardha, të zeza, sipërfaqe të gjelbërta dhe një qendër lagjeje. Investimet që do të vazhdojnë do të jenë koherente me kohën dhe një pjesë e rëndësishme është cilësia e rrugëve dhe siguri i infrastrukturës rrugore për çdo lagje. Lagjja “1 Maj” do të jetë një nga investimet më të mira që do të bëhen në bashki. Një rrugë tjetër që do të investohet është rruga “Kripallarët”, që është shumë problematike. Ne ishim të detyruar të mbyllnim çdo segment rrugor për atë lagje. Kjo rrugë do të filloj së shpejti dhe është e buxhetuar. Gjithashtu edhe shkolla “Sotir Çapo” po rikonstruktohet dhe do të përfundoj. Patosi ka pasur shumë probleme dhe shumë

rrugë, ndriçim dhe ujëra të zeza me probleme. Edhe Ruzhdia ka shumë probleme. Jemi duke punuar te rruga "Ymeraj". Më këtë ndërhyrje që është një nga më të rëndësishmet, kanë përfunduar tre segmente me ndërtimin e mureve mbajtës. Pjesa tjetër e Ruzhdies do vazhdoj në 2026 me sistemimin e rrugëve dhe ndriçimin. Do vazhdoj edhe rruga "Kararaj" në Ruzhdië. Në Patos kanë ngelur disa segmente të vogla për ndërhyrje. Një pjesë është te lagjja "Naftëtari" dhe pjesa që zbret te rruga "Sulo Goxhaj", që është parashikuar me një riveshje të rrugës. Është parashikuar ndërhyrje edhe te rruga pas bankës Reiffeisen. Një tjetër investim është edhe rehabilitimi i ish- fushës së zezë. Është parashikuar rehabilitimi i saj dhe ndërtimi i fushës basketboll, volejboll dhe hapësira shplothëse. Aktualisht ne jemi duke ndërhyrë te kopshti Nr. 1 dhe brenda dhjetorit do përfundoj rikonstruksioni dhe do jetë i ri dhe funksional. Është parashikuar edhe rikonstruksioni i kopshtit Nr. 2 që është te lagjja e Re. Jemi duke vlerësuar faktin që te kopshti Nr. 2 një kat të bëhet çerdhe dhe një kat kopsht pasi kërkesat për çerdhe janë rritur. Në PBA ne kemi edhe rikualifikimin e sheshit para bashkisë, por që të arrijmë deri aty ne duhet të përfundojmë çdo rrugë lagje. Do bëhet edhe rikonstruksioni rrugës para pallatit të Kulturës. Në njësinë Zharrëz janë disa rrugë që do ndërhyet nga ASHP. Është edhe rruga gjatë argjinaturës së lumit Seman. Është bërë edhe pastrimi i kanalit gjatë këtij viti. Një investim që është bërë ka qënë edhe rikonstruksioni i banesave me fondet e bashkisë. Një investim tjetër është edhe rikonstruksioni i MZSH Patos për 2026. Kemi ndërhyrë në hapjen e rrugëve të parcelave që ka lehtësuar edhe kalimin e mjeteve. Investimet në rrugë nga ASHP që do bëhen janë Mjerakët në Zharrëz, Velmishaj në Dukas Breg, Xhelaj dhe Zefaj në Rerës, Ferraj në Fshat i Ri Zharrëz, Dëshmorët e Prishtinës në Grizsë- Lënginas, Enriko Veizi në Patos, rruga e ish dyqaneve, Rrapushajve etj. Gjithashtu gte marrëveshja kuadër janë edhe tre rrugë ne Siqec dhe rrugë në njësinë administrative Zharrëz. Gjithashtu për 2026 do ndërhyet edhe për ndriçimin rrugor. Besoj se ne do të mbyllim njësinë administrative Zharrëz me ndriçim. Do të vazhdoj edhe Patos ndriçimi dhe Ruzhdië. Për 2026 janë parashikuar edhe investime për Patyosin për ato lagje që nuk janë përtfshirë në investimet e tjera. Edhe ne rrugët e ndërmjetme do të ndërhyet në Mustafa Matohiti. Do ndërhyet edhe të pallatet në Zharrëz për rikualifikimin e hapësirave të tyre. Do vazhdojmë edhe me ndërhyrjet në rrjetet e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza në disa segmente. Jemi duke punuar te Përroi në lagjen e Re dhe po mbyllim segmentin 2 të tij. Do të vazhdoj trotuari deri në fund të Përroit dhe do bëhet lidhja me rrugën "Gani Banaj". Kemi filluar edhe rehabilitimin e Përroit në Dukas duke filluar që nga fabrika e Nimetit dhe deri te kanali i bordit të kullimit. Pas përfundimit të punimeve do shikojmë mundësinë e barrierave mbrojtëse për Përroin. Do vazhdojmë edhe me hapjen e rrugëve të parcelave

bujqësore në pjesët e mbetura në Margëlliç, Rerës, Rusinj. Problem tjetër që do vlerësohet për vitin tjetër është linja Patos- Mustafa Matohiti dhe do shikojmë mundësinë e blerjes së një mjeti tjetër. Ky është materiali dhe ndërhyrjet kryesore që do të bëhen në gjithë territorin e bashkisë Patos. Nëse keni pyetje mund të na drejtoheni.

Banore e lagjes “1 Maj”, znj. Donika Shtëmbari- përshëndetje! Banoj në lagje “1 Maj” në



**Banore e lagjes “1 Maj”
znj. Donika Shtëmbari
Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

një pallat që prej shumë vitesh dhe kam një shqetësim që e kam ngritur prej vitesh. Në pallatin tonë është ngritur një hyrje për të gjitha punët që njerëzit mund të kenë në tarac dhe atë kapakun e taracës unë e kam në derën e shtëpisë time. Më thonë që është e përbashkët, por kanë shkaktuar probleme. Mua më është dëmtuar taraca sipër dhe më pikon taraca dhe muri shtëpisë. Kërkoj të verifikohet problemi dhe të ndërhyet nga ana juaj.

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- Përshëndetje! Opinioni dhe mendimi im është që puna e bashkisë ka qënë një punë e mirë. Fjalë të mira do të doja të thoja edhe për zjarrëfikësen pasi kanë bërë një punë të mirë në rastin e rënies së zjarrit. Ju thatë që keni parashikuar rikonstrukcion të MZSH-së, unë mendoj që kjo duhet parë lidhur me funksionalitetin e mjeteve dhe ku është me efikente. Unë do doja të sillja në vëmendjen tuaj një rikonstrukcion të postës së policisë Patos dhe sheshit atje, pasi është në gjendje të keqe. Buxhetin do të doja ta shikonit si një portofol për komunitetin dhe duhet para në këtë aspekt. Ju përgëzoj për të gjitha punët, por do të doja të ishit më konçiz në bërjen e punëve. Nisni më pak projekte dhe përfundojini. Më vjen mirë që janë shtuar kërkesat për çerdhe, por unë kam



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

parë një braktisje të zonave periferike të qytetit për shkak të infrastrukturës. Segmenti rrugor nga bashkia deri Margëlliç është në gjendje të keqe dhe gjithë gropa. Për pjesën e fugonit duhet bërë një studim për oraret dhe shpeshtësinë e tyre dhe do të doja të parashikonit dy mjete. Te buxheti shikoj një investim për sportin dhe kjo është një gjë e mirë. Lidhur me njësinë Ruzhdië, Siqeca nuk e dëgjova për investim. Ai segmenti nga qendra e Siqecës që shkon në Xhepaj është skandalozë. Dua të shikohet mundësia për këtë segment rrugor, pasi ka kohë që janë lënë pas dore.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro – Rrugët e marrëveshjes Kuadër që bëhen nga ana



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

e bashkisë kanë qënë për periudhën 2024-2025-2026. Procedurat e prokurimit janë disa lloje. Kur bëhet një rrugë e caktuar ka një procedurë të gjatë. Marrëveshjen Kuadër e kemi për tre vjet dhe kemi një sasi të caktuar materiali që do përdoret për rrugët. Një pjesë e rrugëve shtyhen në kohë zakonisht për arsye të shtyrjes së kohës së plotësimit me materiale. Rrugët e Rrapushajve dhe dyqaneve do të bëhen të dyja. U bë edhe rruga e Kasnicës, ku ishte e pamundur që të kaloje.

Kryetar i fshatit Rrerës, z. Shaban Ruçaj – Unë dua t’ju falenderoj për punën e bërë deri tani. Ujërat e zeza në Karemanaj u mbyllën, por janë edhe dy segmente të tjera pa mbyllur. Kjo ishte kryesore sepse ishte në mes të lagjes dhe u mbyll. Dy segmentet që kanë ngelur vetëm tubo kërkojnë. U bënë dhe varrezat u thurën, u vendos ndriçimi dhe ka edhe disa probleme. Si fillim dua të theksoj rrugët e brendshme të fshatit. Rruga Buzaj duhet shtruar



**Kryetar i fshatit Rrerës
z. Shaban Ruçaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

dhe duhet filluar bashkë me ndriçim. Rruga e Zekallarëve është me dy degëzime është e pabërë, por e dëgjova të planifikuar. Rruga e Rapushajve nuk është filluar dhe duhen hapur edhe rrugët e parcelave me çakull aty pasi janë 80 familje. Gjithashtu edhe rruga Banaj-Rrerës duhet planifikuar dhe të parashikohet për ndërhyrje më çakull. Edhe rruga jonë Ruçaj ka shumë vite nuk është bërë dhe po prishen makinat aty.

Banor i Rrerësit, z. Ymer Ruçaj- aty në shtëpinë time duhet një ndërhyrje në rrugën Ruçaj



**Banor i Rrerësit
z. Ymer Ruçaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

pasi është në gjendje të keqe dhe po na prishen makinat nuk kalojmë dot.

Banor i lagjes “1 Maj”, z. Shpëtim Resulaj- Përhëndetje! Kam disa sugjerime. Është bërë



**Banor i lagjes “1 Maj”
z. Shpëtim Resulaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

një riparim te dyqani im dhe është lënë përgjysëm një projekt aty. Duhet ta shikoni për përfundim. Gjithashtu janë bërë shumë ambjente shplothëse, por unë kisha një sugjerim. Fëmijët kanë mundësi, por duhte të shikohet mundësia për pishina për fëmijët dhe të moshuarit. Kam edhe një sugjerim tjetër. Depozitat e pallateve duhet të hiqen nga pallatet pasi sjellin rrezik.

Banor i Kuqarit, z. Haredin Rrapaj- Përhëndetje! Kuqari nuk u përmend në asnjë



**Banor i Kuqarit
z. Haredin Rrapaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

investim. Rrugët në Kuqar janë me balt dhe të pashtuara. Unë kam tokën në Kuqar dhe nuk i punoj dot pasi mjeti nuk kalon dot aty për shkak të mungesës së rrugës. Kërkoj të shikohet mundësia për rrugën aty të toka ime.

Banor i qytetit të Patosit, z. Bashkim Buzi- Unë dua të sugjeroj të shikohet rruga Fratar-



**Banor i qytetit të Patosit
z. Bashkim Buzi**

**Dëgjues publik me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Kthesë Patosit. A ka ndonjë plan për këtë rrugë?

Banor i lagjes “1 Maj”, z. Qerem Zyberi- Lidhur me banesat sociale, a ka fonde të




**Banor i lagjes “1 Maj”
z. Qerem Zyberi**

**Dëgjues publik me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

parashikuara për 2026? Unë jam pa banesë, nuk kam ku të banoj dhe kërkoj banesë sociale.

Banor i lagjes Griz, z. Rexhep Zanaj- Për sa i përket rrugës kryesore që hyn në Griz-



**Banor i lagjes Griz
z. Rexhep Zanaj**

**Dëgjues publik me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

Lënginas dhe ujërave të zeza, a do të ketë ndonjë ndërhyrje? Ujërat e zeza pjesa më e madhe e derdh në kanal dhe shkakton ndotje, prandaj kërkojmë ndërhyrje.

Banor i lagjes së Re, z. Ilir Çela- Aty në shtëpinë time ka rënë rruga me gjithë mur. Kur



**Banor i lagjes së Re
z. Ilir Çela**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

kanë punuar për ujërat e zeza i kanë lënë punimet aty. Mua po më dëmtohet pasuria e gjithë. Ujërat e zeza janë lënë para shtëpisë time.

Kryetar i shoqatës së pensionistëve, z. Bashkim Velçani- lidhur me mjediset e argëtimit



**Kryetar i shoqatës së pensionistëve
z. Bashkim Velçani**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

për pensionistët, a është planifikuar ndonjë fond? Qoftë për të bërë ndonjë ekskursion apo ndonjë gjë tjetër. Gjithashtu administrimi i pallateve është një tjetër problem, pasi nuk kanë administrator. Duhet të ngrihen këta administrator që të menaxhojnë problemet e pallatit. Problem tjetër është çertifikimi i banesave që nuk është zgjidhur akoma dhe shumë njerëz nuk kanë çertifikatë. Edhe qentë e rrugës janë problem dhe nuk po i gjendet një zgjidhje pasi po sulmojnë njerëzit.

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Novruz Toska- unë kërkoj të shtohen në buxhet edhe



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Novruz Toska**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

projektet e nisura që janë pa përfunduar. Si kryetar i shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve

ta kthejmë në ambjent funksional për të rinjtë. Rruga Xhelaj filloj dhe do përfundoj, rruga Buzaj nuk është e parashikuar, por duke qënë se keni kërkesë do shikojmë nëse mund ti përfshijmë të fondet e transferuara. Për sa i përket depozitave duhet ndërhyrë, por presim nga ujësjellsit të përfundoj Lotin e nisur që të ndërhyjmë. Në Oficinë për rrugën kemi aplikuar për fond, pasi është investim që ka peshë në buxhet dhe nuk e përballojmë dot. Lidhur me rrugët në Rrerës që tha kryetari i fshatit, janë shumë km rrugë bujqësore dhe kërkojnë shumë investim dhe vlerë të madhe. Për murin te Ilir Çela, KUZ është në punim dhe do përfundoj. Ura në lagjen e Re do zgjerohet. Ndërtimi i pishinave do bëhet kur të përfundoj qendra e Patosit.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

për komentet dhe sugjerimet tuaja. Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjesë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

Koordinatorë e Konsultimit Publik

Simela Shahinaj